 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

(e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

(f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit: _____

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa çmim do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të cojë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	çmimi per njesi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					

TVSH (%)	
Çmimi total me TVSH:	
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Loti i I-rë : “Blerje pajisje per fizioterapine “

Loti i II-të : “Blerje per kabinetin e okulistikes ”

Loti i III-të : “Blerje eko abdominale ”

Specifikimet teknike :

1. Aparature portabel per terapi me ultratinguj.

I lehte per tu perdorur ne cdo suate per stimulim muskular dhe terapeutik. Aparature per terapi me ultratinguj e programueshme për të përdorur transduktorë me ultratinguj në intervalin 1 Mhz- 3 MHz. Terapi ultratinguj me intensitet të programueshëm të vazhdueshme ose të moduluar. Gama e gjerë e protokolleve të paracaktuara me Programe të personalizuar

- Frekuenca ne dalje 1 - 3 MHz
- Intensiteti maksimal 3.0 W/cmq
- Rryma direkte 25 mA*-30 mA*
- Rryma pulsuese 60 mA*- 70 mA*
- Tensioni maksimal i daljes 100 Vdc*
- Njohja automatike e aksesorit të lidhur
- Te jete i pajisur me Transduktorë me frekuencë automatike 1-3 MHz–Ø35 mm

2. Aparature portabel per elektroterapi (Tens)

I lehte per tu perdorur ne per stimulim terapeutik. Te jete i pajisur paraprakisht me game te gjerë te protokolleve të paracaktuara per elektroterapi. Planifikimi i sekuencës së fazave të trajtimit për secilin kanal . Te kete 2 kanale dales te pavarur per stimulim te diferenciuar.

Trajtimi i kushteve inflamatore të muskujve, artikulacioneve, nervave periferike dhe, të traumave dhe hematomave.

- Rryma e vazhdueshme 20 mA – 30 mA
- Rryma pulsuese 60 mA – 70 mA
- Tensioni maksimal i daljes 100 Vdc
- Furnizimi me energji elektrike 90-240 Vac/50-60 Hz

Te jete i pajisur me aksesoret:

- Elektrodë gome përçuese 80x120 mm 4 cope
- Elektrodë gome përçuese 45x60 mm 4 cope

3. Aparature per magneto-terapi. (Magneto)

Pajisje magnetoterapie I lehte per tu perdorur , dhe te emetoje fushë magnetike (ELF) me frekuencë te ulët ,fuqi e ulët rrezatimi dhe depërtim i lartë në inde. Game e gjerë e protokolleve të paracaktuara.Programe të personalizuar.Njohja automatike e aksesorit te lidhur .Sekuenca e planifikimit të fazave.

Frekuenca 2 – 100 Hz

Output 100 / 10 Gauss/mT

Furnizimi me energji elektrike 90-240 Vac / 50-60 Hz

Te jete i pajisur me aksesoret:

- Pllaka plane për magnetoterapi 2 cope
- fasho elastike per fiksime 6 x 100 cm ose 8 x 100 cm

4. Llampe me rreze infra te kuqe. (Llampe infrared)

Llampe profesionale ne stativ me rreze infa te kuqe me lartesi te rregullueshme gjatesia e krahut levizes 70-90 cm, Ngrohja e krijuar nga drita infra të kuqe depërton thellë në lëkurë, stimulon qarkullimin e gjakut dhe ngroh muskujt. Fuqia e llampes 240 – 250 W.

5. Aparature per tekarr terapi. (Tecnoterapi)

I lehte per t'u perdorur, me ekran tip LCD me prekje,. Stimulon reagimin natyror dhe fiziologjik dhe përshpejton proceset riparuese, Trajtimi diatermik terapeutik rezistent dhe kapacitiv

- Game e gjerë e protokolleve të paracaktuara
- Programe të personalizuar
- Modaliteti kapacitiv dhe rezistiv
- Doreze me tre pozicione
- Fuqia maksimale 150W/250VA
- Gama e frekuences 500 kHz/1 MHz
- Furnizimi me energji elektrike 90-240 Vac / 50-60 Hz

Te jete i pajisur me aksesoret:

- Elektrodë neutrale çeliku 160x240mm me kablllo 3 mt
- Doreze 1 cope
- 3 koka kapacitive per dorezen 24-48-62
- 3 koka rezistive per dorezen 24-48-62

Subjekti nese shpallet fitues do te duhet te realizoje edhe vendosjen ne pune te aparaturave

BIOMIKROSKOP OKULISTIK LED 3X

SPECIFIKIME TEKNIKE

Te jete Mikroskop Binokular Konvergues tipi Galilean me konvergim deri ne 6 Grade.

2. Te beje Ndryshimi I zmadhimit Manual me 3 pozicione.

Te kete Shkallet e zmadhimit: 10X,16X,25X

4.Te kete okularin me zmadhim 12.5X me rregullim +/-8D

5. Te kryeje Rregullimin e distances interpupilare 50mm-80mm.

6.Fusha e shikimit te jete 5.7 dei ne 41 mm

7. Gjersia e e hapjes se drites 0-12mm.

8. Gjatesia e hapjes se drites 1-12mm.

9.Kendi I hapjes se drites 0,5,10,15,20 grade.

10. Hapja e diafragmes irisit : ne diametrat 12mm,9mm, 5mm,3mm,1mm,0.2mm.

11. Te kete Filtrat absorbues te nxehtesise,te kuq,jeshil, gri, blu.

12. Te jete me ndricim LED me ndricim minimum 240.000 LUX me rregullim te vazhdueshem .

13. Temperatura e drites 3100 K

14.Tavolina te jete elektrike me lartesi te rregullueshme ose nepermjet pedalit apo metodave ekuivalente.

AUTOREFRAKTOMETER-KERATOMETER

SPECIFIKIMET TEKNIKE:

-Te kryeje te pakten matjet ne menytrat K/R mode, REF mode, KER mode, CLCB mode,K(P) mode , peripheral keratometry.

- Aparature per matje automatike me monitor te levizshem TFT-LCD minimum 7 inch me prekje

Levizja e monitorit te mundesohet ne diapazonin lart poshte deri ne 180 Grade dhe majtas djathtas 135-145 grade

- Distanca Vertex0.0mm deri ne 15.0mm

-
- Mbeshtetsja e mjekres me levizje elektrike
 - Printer termal me shpejtesi te larte
 - Matja PD 30.00mm deri ne 85.00mm
 - Printer termal te integruar
 - Te kryeje transmetimin e te dhenave neperrmjet portes RS232 ose USB
 - Mbeshtetje e mjekres te jete me levizje te kontrolluara
 - Parametrat e matjeve Refraktometri
 - 1- Sfera prej -30.00 deri ne + 25.00D
 - 2- Cilinder prej 0.00 deri ne +/- 10.00D
 - 3- Aksi prej 1 deri ne 180 grade
 - 4- Diametri minimal i pupiles 2.0mm
 - 5- Koha per matjen 0.2 sekonda
 - Parametrat e matjeve / Keratometri
 - ❖ Harku korneal 5mm deri ne13.00mm
 - ❖ Refraksioni Korneal 26.0D deri ne 67.5D
 - ❖ Astigmatizmi corneal 0 deri ne 15D
 - ❖ Aksi nga 1 deri ne 180 grade
 - ❖ Diametri korneal matur me diameter 2.00mm-14.00mm

Subjekti nese shpallet fitues do te duhet te realizoje edhe vendosjen ne pune te aparaturave

Eko per aplikime te pergjithshme

Pershkrim i pergjithshem:

Pajisje ekografike per aplikime te pergjithshme me teknologji bashkekohore.

Aplikimet e perfshira: Abdominale, OB-GYN, Vaskulare, Urologji, Kardiake, Inde te buta, Pediatrike dhe Muskuloskeletale.

Pajisja duhet te kete ekran LED me dimension me rezolucion te larte.

Paisur me te pakten 3 porta per sonda te ndryshme.

Nderfaqe e perdoruesit duhet te jete e pajisur me tastjere alfanumerike dhe me butona te dedikuar skanimi per cdo modalitet skanimi ekografik.

Teknologji dixhitale e sinjaleve ultrasonike me te pakten 200,000 kanale.

Thellesia e fushepamjes ekografike minimale 1 deri ne te pakten 30cm

Fushepamja ekografike duhet te garantohet deri ne te pakten 160 grade.

Banda e frekuencave te funksionimit duhet te perfshije intervalin minimal 2-18 MHz.

Frekuenca e rifreskimit minimale (frame rate) duhet te jete te pakten 1700 fps per te garantuar pergjigje te shpejte, ne kohe reale dhe cilesi imazhi maksimale.

Pajisja duhet te mundesoje funksion zmadhimi te imazhit deri ne te pakten 10-20x.

Pajisur me porte internet dhe funksion per Import/Export te te dhenave nepermjet rrjetit.

Pajisur me dalje video: HDMI me rezolucion te larte interval minimal (1920x1080)

Te perfshihet printer termik A6 bardh e zi i integruar

Furnizimi me energji elektrike: 220V/50Hz.

Menyrat e skanimit qe duhet te perfshihen ne pajisje:

2-Dimensionale

Mundesi zgjedhje per te pakten 4 nivele frekuence funksionimi.

Fuqia dhe amplifikimi ultrasonik i rregullueshem.

Funksione filtrimi software per rritjen e cilesise se imazhit.

Doppler me Ngjyra.

Rregullimi i bazes me te pakten 10 nivele.

Frekuenca e pulseve: 0.5 deri ne 20KHz.

Power Doppler

Mundesi zgjedhje per disa harta ngjyre.

Frekuenca e pulseve: 0.5 deri ne 20KHz.

Doppler Pulsativ PW

Frekuenca e pulseve: 0.5 deri ne 20KHz dhe madhesi kampionimi 1-15mm.

Matja e shpejtesise duke filluar nga 1-1000cm/s.

Identifikim automatik i spektrit dhe matje te parametrave spektrale ne kohe reale.

M-Mode

Mundesi zgjedhje per disa harta gri dhe harta ngjyre te ndryshme.

Mundesi shfaqje te imazhit ne modalitet levizje sebashku me imazh Bi-Dimensional

Matjet:

Te perfshihen ne menyre permanente protokollet e skanimit dhe matjet perkatese per aplikimet e meposhtme:

- Matje Doppler ne kohe reale
- Matje te distancave, diametra, siperfaqe dhe Volume.
- Matje OB-GYN perfshire Biometrine Fetale dhe ndjekjen e rritjes se fetusit
- Matje Vaskulare
- Matje Urologjike
- Matje Kardiake

Aksesore te perfshire:

Nje sonde konvekse 2-Dimensionale me frekuence 2÷5 MHz dhe fushepamje minimale 55°.

Nje Sonde Lineare 2-Dimensionale me frekuence 4÷12 MHz dhe fushepamje 35mm.

Subjekti nese shpallet fitues do te duhet te realizoje edhe vendosjen ne pune te aparaturave

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

- **Loti i I-rë** :“Blerje pajisje per fizioterapine “ , me fond limit 1 189 000 (njemilion e njeqind e tetedhete e nente mije) lekë pa t.v.sh .

Aparature portable per terapi me ultratinguj cope 1 (nje)

Aparature portable per eletroterapi cope 1 (nje)

Aparature per magneto-terapi cope 1 (nje)

Llampe me rreze infra te kuqe cope 1 (nje)

Aparature per tekarr terapi cope 1 (nje)

Afatet e lëvrimit: 10(dhjete) nga data e nenshkrimit te kontrates .

- **Loti i II-të** : “Blerje pajisje per kabinetin e okulistikes “ , me fond limit 1 740 000(njemilion e shtateqind e dyzet mije) lekë pa t.v.sh .

- Biomikroskop okulistik cope 1 (nje)

- Autorefrektometer cope 1 (nje)

Afatet e lëvrimit: 10(dhjete) nga data e nenshkrimit te kontrates .

- Loti i III-te :”Blerje eko abdominale “ , me fond limit 1 540 000 (njemiljon e peseqind e dyzet mije) leke pa t.v.sh

Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Shenim-Kriteret e përgjithshme janë detyruese për të tre lotet perkatëse të procedurës.

2.KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

LOTI I-RË :“BLERJE PAJISJE PER FIZIOTERAPINE“

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; (2% e vlerës së fondit limit të lotit të I-re).*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

1-a)Operatori ekonomik nuk duhet të ketë detyrime të taksave dhe tarifave vendore përfshirë edhe ato të vitit 2022 të njohura nga ana e njesisë vendore ku operatori ekonomik ka selinë në rast se janë plotësuar afatet e maturimit të detyrimeve vendore për periudhën e mesipërme në përputhje me kërkesat e ligjit nr 9632 datë 30.10.2006 “ Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. *(Edhe në rastet e bashkimit të operatoreve duhet të ketë vërtetimin e shlyerjes së taksës vendore 2021 për secilin operator)*

Shenim-Për të përmbushur këto kritere në fazën e ofertimit është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr.8 , ndërsa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, në përputhje me nenin 26.6 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 , duhet të dorëzojë dokumentacionin provues si më poshtë :

-
- Vertetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore përfshirë edhe detyrimet vendore për vitin 2022 të lëshuar nga ana e njesise vendore ku operatori ekonomik ka selinë sipas QKB, në rast se janë plotësuar afatet e maturimit të detyrimeve vendore për periudhën e mesipërme në përputhje me kërkesat e ligjit nr 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. (Edhe në rastet e bashkimit të operatoreve duhet të ketë vertetimin e shlyerjes së taksës vendore 2021 për secilin operator).

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

a)-Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriterëve të Përgjithshme (Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 7).

2. b) **Kërkohet deklaratë e ofertuesit mbi origjinën e mallit (vendi i prodhimit dhe kompania prodhuese ose vetëdeklarim i distributorit të autorizuar) për secilin artikull për respektimin të specifikimeve teknike të kërkuara nga shërbimi mjekësor.**

Argumentimi: Ky kriter vendoset me qëllim njohjen e origjinës së mallit dhe kompanin prodhuese për identifikimin në mënyrë të qartë gjatë levrimit të tij dhe për të pasur siguri që i njëjti mall i ofruar do të levrohet në destinacion në përputhje me nenin 40 pika 6 dhe 8 të vkm 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kjo kërkesë i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e mundësive për njohjen e mundësive të operatorit ekonomik për përmbushjen me sukses të kontratës pra të garancojë se furnizimi i mallit objektprokurimi.

3. Pajisjet mjekësore të jenë të certifikuara në CE ose FDA sipas standarteve dhe direktivave të aprovuara. Kjo pikë mund të plotësohet edhe nëpërmjet paraqitjes së autodeklaratës/deklaratës konformiteti (DC), nga operatori ekonomik. Kërkohet Autodeklarate për pajisjet mjekësore nga ofertuesi për konformitetin me normat MDD 93/42/EEC/Regulation (EU) 2017/745/ose ekuivalent (sipas aplikimit të vlefshmerisë)

Argumentim: Ky kriter vendoset në përputhje me pikën 6/c të nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, lidhur me dëshmitë për rezultatet e testeve zyrtare të lëshuara nga institucione të autorizuar që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. Certifikimi CE i këtyre materialeve është obligator në zbatim të Ligjit 89/2014 “Për pajisjet mjekësore”(nenit 17 dhe 18) si dhe rekomandimit të APP nr. 3341/1 datë 20.03.2018 “Mbi hartimin e kriterëve për kualifikim në DT të procedurave të prokurimit”.

4. Për të gjithë artikujt e ofruar të paraqiten katalogje, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për secilin artikull. Operatori ekonomik duhet të markojë në katalogun përkatës produktet që ofron sipas numrit rendor (të markuara sipas artikullit) të përcaktuar në formularin e ofertës.

Argumentim: Ky kriter vendoset në përputhje me piken 6/b të nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, lidhur me dëshmitë për fotografitë ose katalogët teknike.

5. Neqoftese ka dokumenta ne gjuhe te huaj ato duhen te jene te perkthyer ne shqip dhe te noterizuara .Te gjithë dokumentat duhet te jene origjinale ose kopje te noterizuara te tyre. Rastet e mosdorezimit te nje dokumenti , ose te dokumentave te rreme e te pasakta , konsiderohen si kusht per skualifikim .

6. Ofertuesi duhet të jetë i certifikuar me ISO 9001:2008 ose 9001:2015 per distribuim, tregëtim të pajisjeve mjekësore Për këtë ai duhet të paraqesë certifikatën përkatëse të përkthyer dhe të noterizuar a) Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqese certifikatën ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, me objekt aktiviteti të certifikates per tregëtim të materialeve mjekësore në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga nje organ i vleresimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

b) Operatori ekonomik ofertues në rastet kur nuk është prodhues i artikujve objekt prokurimi, duhet të paraqesë autodeklaratë që furnizuesi nga i cili siguron artikujt objekt prokurimi është i certifikuar konform standarteve të cilësisë ISO 9001:2015 /ose/ ekuivalent mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose ISO 13485:2016 mbi “Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore”, të vlefshme, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga nje organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentim: Ky kriter vendoset në përputhje me të nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, lidhur me certifikimin e cilesise se mallrave objekt prokurimi.

e) Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim të vlefshëm të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Per te provuar permbushjen kriterëve ekonomike e financiare operatori ekonomik duhet te plotesoje kerkesat minimale si me poshte duke dorezuar :

a)Operatori/et Ekonomik duhet të paraqes/in kopje të deklarimit të xhiros vjetore per 3(tre) vitet financiare (2019,2020,2021) , ose vertetimin e lëshuar nga autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vleres e fondit limit të kontrates (**lotit nr 1**), qe prokurohet përkatësisht ne shumen prej **475’600 (katerqind e shtatedhete e pesemije e gjashteqind) leke pa t.v.sh**

Shenim-Pika 2.3-a) plotësohet duke paraqitur edhe vertetimin perkates te Administrates Tatimore

2.3-Kapaciteti teknik:

2.3-1. Operatori ekonomik duhet të paraqese dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë tri viteve të fundit me një vlerë jo më të vogël se 20 % e vlerës së përlogaritur të kontratës (**lotit nr .1**), që prokurohet dhe konkretisht jo më pak se **237'800(dyqind e tridhjetë e shtatë mijë e teteqind) leke pa t.v.sh**

, dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit. nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a)-për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
b)-për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

2.3.5-a)Operatori ekonomik i shpallur fitues duhet të marrë përsipër të furnizoje/transportoje mallrat objekt kontrate, në vendet e percaktuara nga ana e Drejtorise së Sherbimit Spitalor “Dr. Stefan Gjoni “Kruje me mjetet e tij që ka në dispozicion sipas kërkesës së AK sipas kushteve të percaktuara në kontratë..

Shenim: Në zbatim të nenit 82.5 të Ligjit nr 162/2020 “Per Prokurimin Publik” dhe të pikës 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku parashikohet : *“Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike¹. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.*

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

- Autoriteti Kontraktor do të beje verifikimin e dokumentacionit të operatorit fitues para lidhjes së kontratës , në përputhje me vetedeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht s’kualifikimi.

¹ Ndryshuar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

2.KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

LOTI II-TË : ‘BLERJE PAJISJE PER KABINETIN E OKULISTIKES’

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; (2% e vleres se fondit limit te lotit te II-te).*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

1-a)Operatori ekonomik nuk duhet te kete detyrime te taksave dhe tarifave vendore perfshire edhe ato te vitit 2022 te njohura nga ana e njesise vendore ku operatori ekonomik ka seline ne rast se jane plotesuar afatet e maturimit te detyrimeve vendore per periudhen e mesiperme ne perputhje me kerkesat e ligjit nr 9632 date 30.10.2006 ‘‘ Për sistemin e taksave vendore’’, i ndryshuar. *(Edhe ne rastet e bashkimit te operatoreve duhet te kete vertetimin e shlyerjes se taksës vendore 2022 per secilin operator)*

Shenim-Per te permbushur kete kriter ne fazen e ofertimit është e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas shtojcës nr.8 , ndersa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, ne perputhje me nenin 26.6 te VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 , duhet te dorezoje dokumentacionin provues si më poshtë :

- Vertetim per shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore perfshire edhe detyrimet vendore per vitin 2022 te leshuar nga ana e njesise vendore ku operatori ekonomik ka seline sipas QKB, ne rast se jane plotesuar afatet e maturimit te detyrimeve vendore per periudhen e mesiperme ne perputhje me kerkesat e ligjit nr 9632 date 30.10.2006 ‘‘ Për sistemin e taksave vendore’’, i ndryshuar. *(Edhe ne rastet e bashkimit te operatoreve duhet te kete vertetimin e shlyerjes se taksës vendore 2022 per secilin operator).*

2.1Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

a)-Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriterëve të Përgjithshme (Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 7).

6. b) **Kërkohet deklarate e ofertuesit mbi origjinen e mallit (vendi i prodhimit dhe kompania prodhuese ose vetëdeklarim i distributorit të autorizuar) per secilin artikull per respektimit te specifikimeve teknike te kërkuara nga shërbimi mjekesor.**

Argumentimi: Ky kriter vendoset me qellim njohjen e origjines se mallit dhe kompanin prodhuese per identifikimin ne menyre te qarte gjate levrimit te tij dhe per te pasur siguri qe i njeiti mall i ofruar do te levrohet ne destinacion ne perputhje me nenin 40 pika 6 dhe 8 te vkm 285 date 19.05.2021 " Per miratimin e rregullave te prokurimit publik". Keto kerkesa i sherbejne autoritetit kontraktor per njohjen e mundesise per njohjen e mundesise se operatorik ekonomik per permbushjen me sukses te kontrates pra te garancise se furnizimit te mallit objektprokurimi.

7. Pajisjet mjekesore te jene te certifikuara ne CE ose FDA sipas standarteve dhe direktivave te aprovuara.Kjo pike mund te plotesohet edhe nepermjet paraqitjes së autodeklaratës/deklaratë konformiteti (DC), nga operatori ekonomik. Kerkohet Autodeklarate per pajisjet mjekesore nga ofertuesi per konformitetin me normat MDD 93/42/EEC/Regulation (EU) 2017/745/ose ekuivalent (sipas aplikimit te vlefshmerise)

Argumentim: Ky kriter vendoset në përputhje me pikën 6/c të nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", lidhur me dëshmitë për rezultatet e testeve zyrtare të lëshuara nga institucione te autorizuar që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. Certifikimi CE i këtyre materialeve është obligator në zbatim të Ligjit 89/2014 "Për pajisjet mjekësore"(nenit 17 dhe 18) si dhe rekomandimit të APP nr. 3341/1 datë 20.03.2018 "Mbi hartimin e kriterëve për kualifikim në DT të procedurave të prokurimit".

8. Për të gjithë artikujt e ofruar te paraqiten katalogje, ku te përfshihen edhe specifikimet teknike te hollësishme për secilin artikull.Operatori ekonomik duhet te markoje ne katalogun perkates produktet qe ofron sipas numrit rendor (te markuara sipas artikullit) te percaktuar ne formularin e ofertes.

Argumentim: Ky kriter vendoset në përputhje me pikën 6/b të nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", lidhur me dëshmitë për fotografitë ose katalogët teknike.

9. Neqoftese ka dokumenta ne gjuhe te huaj ato duhen te jene te perkthyer ne shqip dhe te noterizuara .Te gjithë dokumentat duhet te jene origjinale ose kopje te noterizuara te tyre. Rastet e mosdorezimit te nje dokumenti , ose te dokumentave te rreme e te pasakta , konsiderohen si kusht per skualifikim .

6. Ofertuesi duhet të jetë i certifikuar me ISO 9001:2008 ose 9001:2015 per distribuim, tregëtim të pajisjeve mjekësore Për këtë ai duhet të paraqesë certifikatën përkatëse të përkthyer dhe të noterizuar a) Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqese çertifikatën ISO 9001:2015 mbi "Sistemet

e menaxhimit të cilësisë”, me objekt aktiviteti të certifikates për tregëtim të materialeve mjekësore në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

b) Operatori ekonomik ofertues në rastet kur nuk është prodhues i artikujve objekt prokurimi, duhet të paraqesë autodeklaratë që furnizuesi nga i cili siguron artikujt objekt prokurimi është i çertifikuar konform standarteve të cilësisë ISO 9001:2015 /ose/ ekuivalent mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose ISO 13485:2016 mbi “Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore”, të vlefshme, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentim: Ky kriter vendoset në përputhje me të nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, lidhur me certifikimin e cilësisë së mallrave objekt prokurimi.

e) Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim të vlefshëm të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Per të provuar përmbushjen kriterëve ekonomike e financiare operatori ekonomik duhet të plotësojë kërkesat minimale si më poshtë duke dorëzuar :

a) Operatori/et Ekonomik duhet të paraqes/in kopje të deklaramit të xhiros vjetore për 3(tre) vitet financiare (2019,2020,2021) , ose vërtetimin e lëshuar nga autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të kontratës(**lotit nr 2**), që prokurohet përkatësisht në shumën prej 696’000 (**gjahteqind e nentedhejte e gjashte mije) leke pa t.v.sh**

Shenim-Pika 2.3-a) plotësohet duke paraqitur edhe vërtetimin përkatës të Administratës Tatimore

2.3-Kapaciteti teknik:

2.3-1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë tri viteve të fundit me një vlerë jo më të vogël se 20 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës(**lotit nr .2**), që prokurohet dhe konkretisht jo më pak se- **348’000 (treqind e dyzet e tete mije) leke pa t.v.sh** , dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit. nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a)-për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të

shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara, b)-për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

2.3.5-a)Operatori ekonomik i shpallur fitues duhet të marrë përsipër të furnizoje/transportoje mallrat objekt kontrate, në vendet e percaktuara nga ana e DSHS-KRUJE me mjetet e tij që ka në dispozicion sipas kërkesës së AK sipas kontratës së nënshkruar ,

Shenim:Ne zbatim të nenit 82.5 të Ligjit nr 162/2020 ‘‘Per Prokurimin Publik’’ dhe të pikës 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku parashikohet : ‘‘Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat ‘‘a’’, ‘‘b’’, ‘‘d’’, ‘‘dh’’, ‘‘e’’, ‘‘h’’, ‘‘i’’, ‘‘j’’ të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike². Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

- Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit të operatorit fitues para lidhjes së kontratës , në përputhje me vetëdeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht s’kualifikimi.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

2.KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

LOTI III-TË : ‘‘BLERJE EKO ABDOMINALE

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

² Ndryshuar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; (2% e vlerës së fondit limit të **lotit të III-te**).

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

1-a) Operatori ekonomik nuk duhet të ketë detyrime të taksave dhe tarifave vendore përfshirë edhe ato të vitit 2022 të njohura nga ana e njesise vendore ku operatori ekonomik ka selinë në rast se janë plotësuar afatet e maturimit të detyrimeve vendore për periudhën e mesipërme në përputhje me kërkesat e ligjit nr 9632 datë 30.10.2006 “ Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. *(Edhe në rastet e bashkimit të operatoreve duhet të ketë vertetimin e shlyerjes së takses vendore 2022 për secilin operator)*

Shenim- Për të përmbushur këtë kriter në fazën e ofertimit është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr.8 , ndërsa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, në përputhje me nenin 26.6 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 , duhet të dorëzojë dokumentacionin provues si më poshtë :

- Vertetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore përfshirë edhe detyrimet vendore për vitin 2022 të leshuar nga ana e njesise vendore ku operatori ekonomik ka selinë sipas QKB, në rast se janë plotësuar afatet e maturimit të detyrimeve vendore për periudhën e mesipërme në përputhje me kërkesat e ligjit nr 9632 datë 30.10.2006 “ Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. *(Edhe në rastet e bashkimit të operatoreve duhet të ketë vertetimin e shlyerjes së takses vendore 2022 për secilin operator).*

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

a)-Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriterëve të Përgjithshme (Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 7).

10. Kërkohe deklaratë e ofertuesit mbi origjinën e mallit (vendi i prodhimit dhe kompania prodhuese ose vetëdeklarim i distributorit të autorizuar) për secilin artikull për respektimin të specifikimeve teknike të kërkuara nga shërbimi mjekësor.

Argumentimi: Ky kriter vendoset me qëllim njohjen e origjinës së mallit dhe kompanin prodhuese për identifikimin në mënyrë të qartë gjatë levrimit të tij dhe për të pasur siguri që i njëjti mall i ofruar do të levrohet në destinacion në përputhje me nenin 40 pika 6 dhe 8 të vkm 285 datë 19.05.2021 “ Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Këtë kërkesë i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e mundësive për njohjen e mundësive së operatorit ekonomik për përmbushjen me sukses të kontratës pra të garancojë se furnizimit të mallit objektprokurimi.

11. Pajisjet mjekësore të jenë të certifikuara në CE ose FDA sipas standarteve dhe

direktivave te aprovuara.Kjo pike mund te plotesohet edhe nepermjet paraqitjes së autodeklaratës/deklaratë konformiteti (DC), nga operatori ekonomik. Kerkohet Autodeklarate per pajisjet mjekesore nga ofertuesi per konformitetin me normat MDD 93/42/EEC/Regulation (EU) 2017/745/ose ekuivalent (sipas aplikimit te vlefshmerise)

Argumentim: Ky kriter vendoset në përputhje me pikën 6/c të nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, lidhur me dëshmitë për rezultatet e testeve zyrtare të lëshuara nga institucione të autorizuar që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. Certifikimi CE i këtyre materialeve është obligator në zbatim të Ligjit 89/2014 “Për pajisjet mjekësore”(nenit 17 dhe 18) si dhe rekomandimit të APP nr. 3341/1 datë 20.03.2018 “Mbi hartimin e kriterëve për kualifikim në DT të procedurave të prokurimit”.

12. Për të gjithë artikujt e ofruar te paraqiten katalogje, ku te përfshihen edhe specifikimet teknike te hollësishme për secilin artikull.Operatori ekonomik duhet te markoje ne katalogun perkates produktet qe ofron sipas numrit rendor (te markuara sipas artikullit) te percaktuar ne formularin e ofertes.

Argumentim: Ky kriter vendoset në përputhje me pikën 6/b të nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, lidhur me dëshmitë për fotografitë ose katalogët teknike.

13. Neqoftese ka dokumenta ne gjuhe te huaj ato duhen te jene te perkthyer ne shqip dhe te noterizuara .Te gjithe dokumentat duhet te jene origjinale ose kopje te noterizuara te tyre. Rastet e mosdorezimit te nje dokumenti , ose te dokumentave te rreme e te pasakta , konsiderohen si kusht per skualifikim .

6. Ofertuesi duhet të jetë i certifikuar me ISO 9001:2008 ose 9001:2015 per distribuim, tregëtim të pajisjeve mjekësore Për këtë ai duhet të paraqesë certifikatën përkatëse të përkthyer dhe të noterizuar a) Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqese çertifikatën ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, me objekt aktiviteti te certifikates per tregetim të materialeve mjekësore në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise. Çertifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

b) Operatori ekonomik ofertues në rastet kur nuk është prodhues i artikujve objekt prokurimi, duhet të paraqesë autodeklaratë që furnizuesi nga i cili siguron artikujt objekt prokurimi është i çertifikuar konform standarteve të cilësisë ISO 9001:2015 /ose/ ekuivalent mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose ISO 13485:2016 mbi “Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore”, të vlefshme, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentim: Ky kriter vendoset në përputhje me të nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, lidhur me certifikimin e cilësisë së mallrave objekt prokurimi.

e) Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim të vlefshëm të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

Per te provuar permbushjen kriterëve ekonomike e financiare operatori ekonomik duhet te plotesoje kerkesat minimale si me poshte duke dorezuar :

a) Operatori/et Ekonomik duhet të paraqes/in kopje të deklaramit të xhiros vjetore per 3(tre) vitet financiare (2019,2020,2021) , ose vertetimin e lëshuar nga autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës e fondit limit të kontratës(**lotit nr 2**), që prokurohet përkatësisht në shumën prej **616’000(gjashtëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë) leke pa t.v.sh**

Shenim-Pika 2.3-a) plotësohet duke paraqitur edhe vertetimin përkatës të Administratës Tatimore

2.3-Kapaciteti teknik:

2.3-1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë tri viteve të fundit me një vlerë jo më të vogël se 20 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës(**lotit nr .3**), që prokurohet dhe konkretisht jo më pak se 308’000 (treqind e tete mijë) **leke pa t.v.sh** , dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit. nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

